

VENDIM
Nr. 571, datë 6.10.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË 35 NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË GRANTIT TË LIDHUR NDËRMJET AGJENCISË SË ZHVILLIMIT AUSTRIAK (ADA) DHE MINISTRIT TË SHQIPËRISË PËR RINDËRTIMIN, PËR PROJEKTIN “PËRGJIGJE NDAJ TËRMETEVE NË SHQIPËRI”

(ndryshuar me VKM nr. 801, datë 28.12.2023)

(përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 129 087 000 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të 35 njësive individuale të banimit brenda zonës së re për zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, në zbatim të marrëveshjes së grantit të lidhur, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit Austriak (ADA) dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për projektin “Përgjigje ndaj tërmeteve në Shqipëri”.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 121 743 141 (njëqind e njëzet e një milionë e shtatëqind e dyzet e tre mijë e njëqind e dyzet e një) lekë pa TVSH, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

2/1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në masën 7 343 859 (shtatë milionë e treqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj